

KLUBI I TEKNIKËVE

Tipi i Programit: Plotësues

Historiku i Programit

Idea e zhvillimit të këtij programi ka lindur nga vështirësitë që i kanë shkollat në mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike dhe përdorimin e tyre gjatë procesit mësimor. Aq më shumë nga mungesa e përvojës së mësimdhënësve dhe hezitimin e tyre për integrimin e teknologjisë arsimore në punën e tyre të përditshme.

Ky program ju mundëson pjesëmarrësve të formojnë dhe menaxhojnë klubin e teknikëve në shkollë. Funksionimi i këtij klubi do të ndikojë në integrimin e teknologjisë arsimore në procesin mësimor e me këtë edhe zbatimin e kurrikulës së re të Kosovës. Ky klub do të bëjë mirëmbajtjen e pajisjeve arsimore brenda shkollës, përkrahjen e mësimdhënësve në përdorimin e teknologjisë, përkrahë mësimdhënësit në dokumentimin e punës së tyre me pajisje arsimore, kontribojë në zhvillimin e projekteve të ndryshme brenda shkollës etj. Pjesëtarë të këtij klubi do të jenë nxënësit e klasëve VI, VII, VIII, IX, X, XI dhe XII. Kompetencat e arritura nga ky trajnim janë të bazuara në rezultatet mësimore nga Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ultë dhe lartë të Kosovës, Gjimnazet dhe shkollat profesionale – klasa VI, VII, VIII, IX, X, XI, dhe XII

Qëllimet e programit:

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit duhet të jenë gjendje të:

- formojnë klubin e teknikëve për të përkrahur mësimdhënësit/et dhe nxënësit/et në shfrytëzimin e pajisjeve të teknologjisë informative;
- mirëmbajnë laboratorin e teknologjisë informative si nga ana harduerike ashtu edhe nga ana softuerike;
- bëjnë menaxhim bazik të rrjetave;
- njohin rreziqet e mundshme gjatë përdorimit të pajisjeve arsimore;
- analizojnë përdorimin e drejtë dhe jo të drejtë të pajisjeve arsimore në shkollë;
- shfrytëzojnë udhëzime të ndryshme nga manuali për tu siguruar në përdorimin e drejtë të pajisjeve në shkollë;
- krijojnë njësi/ aktivitete praktike në fokus integrimin e lëndëve në mes veti.

Përmbajtja:

Ky program është i dedikuar për mësimdhënësit e fushës mësimore 'Jeta dhe puna'. Përmes trajnimit të mësimdhënësve në këtë program fillimisht do të afektohen një numër i caktuar i nxënësve të shkollës, pjesëtarëve të klubit. Këta nxënës pastaj do të ndikojnë në përdorimin e pajisjeve arsimore në shkollë e me këtë edhe mësimin praktik jo vetëm në lëndën e TIK-ut por në të gjitha lëndët.

Grupi i synuar

Të gjithë mësime të fushës 'jeta dhe puna' të shkollave të mesme të larta, Gjimnazeve dhe shkollave profesionale, respektivisht klasave VI, VII, VIII, IX, X, XI, dhe XII. Ky program trajnimi do të duhet të ishte plotësues sa i përket licencimit të tyre. Ndërsa, ky program poashtu është i përshtatshëm edhe për mësime të fushave tjera mësimore të interesuar në teknologji arsimore të këtij niveli të shkollimit, si trajnim plotësues, numri i të cilëve nuk është i kufizuar. Përmes mësimeve të trajnuar, do të punohet me nxënësit e shkollës, pjesëtar të klubit.

Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Pjesëmarrësit e identifikuar do të vijojnë tri ditë të plota, secila ditë me nga katër sesione 90 minutëshe, të moderuara nga fasilituesit profesional. Pas trajnimit, mësime do të formojnë dhe funksionalizojnë klubet e teknikëve në shkollë, dhe gjatë kësaj periudhe do të mentorohen nga fasilituesit e programit, që të mbështeten në përmbushjen e kërkesave për certifikim.

Vlerësimi/Certifikimi

Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit mësime do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 24 orë trajnimi (6 orë x 3 ditë= 18 orë; plus 6 orë të kalkuluara për krijimin e klubeve dhe aktiviteteve në shkollë gjatë procesit të reflektimit /mentorimit).

Kriteret për certifikim janë:

- 90% pjesëmarrje në trajnim dhe në takimet reflektuese me mentor;
- Portfolio që dëshmon se janë formuar klubet e teknikëve në shkollë dhe klubi është funksional në mirëmbajtjen e pajisjeve arsimore në shkollë, përkrahjen e mësimeve në përdorimin e pajisjeve arsimore, dokumentimi i përdorimit të pajisjeve arsimore në shkollë, si dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në shkollë. Preferohet që kjo portfolio të jetë online, në kuadër të uebfaqes së shkollës apo e pavarur;

Materialet e trajnimit

- Udhëzuesi për fasilitues të programit trajnues;
- Sllajdet në Power Point / Video prezentimet;
- Dokumenti i punuar nga Microsoft për klubet e teknikëve.